



Pranuar / Dorezuar Punijeno / Prodato Received / Delivery	31.05.2021	1	viti god year
Organ / Njësia Organi / Jedinica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIPKSHCK	2734/2021		1/4



## Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.344/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Eshref Shabani dhe Malsore Gashi-Bajraktari-anëtarë me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, sipas Aktgjykimit A.nr.169/20 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamentit për Çështje Administrative, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.699/2019 të datës 07.11.2019 të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi fshati Velekincë, Komuna e Gjilanit, te ushtruar kundër organit të punësimit/ Administrata Tatimore e Kosovës, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 31.05.2021, mori këtë:

### V E N D I M

- I. Refuzohet si e pa bazuar ankesa me numër A.nr.699/2019 e datës 07.11.2019 e parashtruar nga ankuesi
- II. Mbetet në fuqi Njoftimi i datës 08.10.2019 për kandidatin e suksesshëm për procedurën e rekrutimit "Udhëheqës i Ekipit të Mbledhjes së Detyrueshme në Gjilan" të shpallur nga Administrata Tatimore e Kosovës.

### A r s y e t i m

Administrata Tatimore e Kosovës, me datë 16.09.2019 ka shpallur konkurs të brendshëm për plotësimin e pozitës "Udhëheqës i Ekipit të Mbledhjes së Detyrueshme në Gjilan". Në këtë konkurs ka aplikuar edhe ankuesi i cili është ftuar të marrë pjesë në fazat e procedurës së rekrutimit (testin me shkrim dhe me gojë). Administrata Tatimore e Kosovës pas përfundimit të procedurës së rekrutimit, më datë 08.10.2019 ka publikuar njoftimin për kandidatin e suksesshëm në bazë të të cilit ankuesi nuk është kandidat i suksesshëm.

Ankuesi kundër njoftimit të datës 08.10.2019 për kandidatin e suksesshëm, më datë 07.11.2019 ka parashtruar ankesë me numër të protokollit 5261/2019 të regjistruar me numër A.nr.699/2019 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 12.11.2019, ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë te Administrata Tatimore e Kosovës. Këshilli me datë 20.11.2019 ka pranuar përgjigjën me shkrim se bashku me dokumentet e bashkangjitura të lëndës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në mungesë të kuorumit për vendosje ka udhëzuar ankuesin për ushtrimin e mjeteve juridike në gjykatë sipas dispozitave të Ligjit për Konfliktin Administrativ. Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, më datë 26.04.2021 ka nxjerr Aktgjykim A.nr.169/20 përmes të cilit ka detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, që të shqyrtoje dhe të vendos për ankesën e datës 07.11.2019 të parashtruar nga

**Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova:** Ankesën me numër protokollit 5261/2019 të datës 07.11.2019 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin e datës 28.12.2018 për transferimin e ankuesit; E-mailin e datës 16.09.2019 për njoftim për shpalljen e konkurseve të brendshme; Konkursin e brendshëm të datës 16.09.2019 të shpallur për pozitën "Udhëheqës i Ekipit të Mbledhjes së Detyrueshme në Gjilan" nga Administrata Tatimore e Kosovës; E-mailin e datës 22.02.2017 nga T. E-mailin e datës 11.10.2019 nga Kërkesën për fillimin e rekrutimit (punësimin) i datës 17.05.2019; Autorizimi i DASHC/MAP i datës 10.09.2019; Miratim për publikimin e rekrutimit të brendshëm i datës 10.09.2019; Vendimin e datës 24.09.2019 për emërimin e kryesuesit dhe anëtarëve të Komisionit Përzgjedhës të Shërbimit Civil; Formularin Form.MAP-SHCK-04 për regjistrin e aplikacioneve të pranuar; Formularin Form.MAP-SHCK-096 për njoftimin për kandidatët për testimin nga përzgjedhja e ngushtë i datës 30.09.2019; Formularin Form.MAP-SHCK-07c për njoftim për mbajtjen e intervistës me gojë; Formularin Form.MAP-SHCK-11 për raportin final me rekomandim nga komisioni rekrutues i datës 08.10.2019; Njoftimin për kandidatin e suksesshëm i datës 08.10.2019; Formularin Form. MAP-SHCK-08a për vlerësimin individual të kandidatëve kur nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhe të huaj për ankuesin, S. dhe Kërkesën për punësim e datës 20.09.2019 të ankuesit, Formularin për vlerësimin e rezultateve në punës për vitin 2018, 2017, Diplomën e ankuesit, Certifikatën 10.03.2000, 15.04-11.10.2013, janar-dhjetor 2006, 05.06.2009, 05.05.2009, 14.01-18.07.2006, 18.10-15.11.2006, 18.04-07.06.2006, 08.03-11.04.2006, 18.01-01.03.2006, 21-24.03.2005; Testin me shkrim i datës 02.10.2019 i ankuesit; Kërkesën për punësim e datës 19.09.2019 e kandidatës Diplomën e kandidatës Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2017, 2018 dhe 01.01-30.06.2019 për kandidaten B.Musliu, Akt Emërimin e datës 14.12.2012 për kandidaten Cerifiaktën e datës 01.06.2001 për kandidaten Testin me shkrim i datës 02.10.2019 për kandidaten Kërkesën për punësim e datës 20.09.2019 për kandidatin Formularin për vlerësimin e rezultateve në punës për vitin 2017, 2018, Diplomat e kandidatin Testin me shkrim të datës 02.10.2019 të kandidatin dhe Përgjigjen në ankesë e datës 20.11.2019 me numër protokollit 5457/2019; Aktgjykimin



A.nr.169/20 të datës 26.04.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamentit për Çështje Administrative dhe Njoftimin e datës 23.12.2019.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar që ankesa e ankuesit *është e pa bazuar, sepse:*

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit i cili pretendon se procedura e rekrutimit për pozitën "Udhëheqës i Ekipit të Mbledhjes së Detyrueshme në Gjilan" është zhvilluar me shkelje procedurale pasi që në kohën e zhvillimit të saj ka qenë në fuqi Ligji Nr.06/114 për Zyrtarët Publikë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, duke shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit, ka konstatuar se Administrata Tatimore e Kosovës kërkesën për fillimin e rekrutimit-punësimit e ka bërë më datë 17.05.2019 në pajtim me nenin 9 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, ndërsa Departamenti i Administrimit të Shërbimit Civil/Ministria e Administratës Publike më datë 10.09.2019 ka miratuar kërkesën për shpalljen e konkursit për pozitën "Udhëheqës i Ekipit të Mbledhjes së Detyrueshme në Gjilan". Sipas këtij autorizimi, Administrata Tatimore e Kosovës më datë 16.09.2019 ka shpallur konkurs të brendshëm, e cila procedurë ka qenë e hapur për tetë (8) ditë.

Kolegji, lidhur me pretendimet ankimore të ankuesit ka analizuar dispozitat transitorë të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenin 83 paragrafi 9 ku përcaktohet se: *Institucionet publike do të sigurojnë përfundimin e konkursit të shpallur dhe procedurave të tjera të nisura para hyrjes në fuqi të këtij ligji...*, dhe si rrjedhojë ka konstatuar se Administrata Tatimore e Kosovës ka vepruar drejtë me rastin e aplikimit të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil, sepse kjo procedure e rekrutimit konsiderohet se ka filluar me lëshimin e autorizimit për shpallje të konkursit, me datën 10.09.2019, në kohën sa ka qenë i zbatueshëm Ligji për Shërbimin Civil, dhe e njëjta procedure është dashur të vazhdojë sipas dispozitave të këtij ligji. Në këtë kuptim, Kolegji vlerëson se Administrata Tatimore e Kosovës konkursin e ka shpallur në pajtim me Ligjin Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2010 për procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, kështu që pretendimi i ankuesit është i pa bazuar.

Po ashtu Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se procedura e rekrutimit për pozitën "Udhëheqës i Ekipit të Mbledhjes së Detyrueshme në Gjilan", ka përfunduar brenda afateve ligjore të përcaktuara me dispozitat e Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil.


Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A.nr.344/2021

**Avdyr BEKTESHI**

  
Procesmbajtës



**Vendimi i dërgohet**

- Ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm të Administratës Tatimore të Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit në Administratën Tatimore të Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

